



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria-Vlada-Government

PROJEKTLIGJI PËR QEVERINË E REPUBLIKËS SË KOSOVËS¹

DRAFT LAW ON GOVERNMENT OF THE REPUBLIC OF KOSOVO²

NACRT ZAKON O VLADI REPUBLIKE KOSOVA³

¹ Projektligji për Qeverinë e Republikës së Kosovës, është miratuar në mbledhjen e 52 - të Qeverisë së Republikës së Kosovës me vendimin Nr.02/52 të datës 29.12.2021.

² Draft Law on Government of the Republic of Kosovo, was approved in the 52 - meeting of the Government of Republic of Kosova with the decision No: 02/52 dt: 29.12.2021.

³ Nacrt Zakona o Vladi Republike Kosova, usvojen je na 52 sednicu Vlade Kosova, sa odlukom Br.02/52, datum 29.12.2021.

<p>Kuvendi i Republikës së Kosovës,</p> <p>Në mbështetje të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,</p> <p>Miraton:</p> <p>LIGJ PËR QEVERINË E REPUBLIKËS SË KOSOVËS</p> <p>KAPITULLI I- DISPOZITAT E PËRGJITHSHME</p> <p>Neni 1 Qëllimi</p> <p>1. Me këtë ligj përcaktohen:</p> <p>1.1. Organizimi dhe mënyra e funksionimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Qeveria);</p> <p>1.2. Mënyra e punës dhe procedurat e vendimmarrjes në Qeveri, dhe</p> <p>1.3. Marrëdhënia ndërmjet Qeverisë dhe Kuvendit të Republikës së</p>	<p>Assembly of the Republic of Kosovo,</p> <p>Pursuant to article 65 (1) of the Constitution of the Republic of Kosovo,</p> <p>Approves:</p> <p>LAW ON GOVERNMENT OF THE REPUBLIC OF KOSOVO</p> <p>CHAPTER I- GENERAL PROVISIONS</p> <p>Article 1 Purpose</p> <p>1. This law determines:</p> <p>1.1. Organization and manner of functioning of the Government of the Republic of Kosovo (hereinafter: the Government);</p> <p>1.2. Method of work and decision-making procedures in the Government, and</p> <p>1.3. The relationship between the Government and the Assembly of the</p>	<p>Skupština Republike Kosova,</p> <p>Na osnovu člana 65 (1) Ustava Republike Kosova,</p> <p>Usvaja:</p> <p>ZAKON O VLADI REPUBLIKE KOSOVA</p> <p>POGLAVLJE I- OPŠTE ODREDBE</p> <p>član 1 Svrha</p> <p>1. Ovim zakonom se utvrđuje:</p> <p>1.1. Organizacija i način funkcionisanja Vlade Republike Kosovo (u daljem tekstu: Vlada);</p> <p>1.2. Način rada i postupak odlučivanja u Vladi, i</p> <p>1.3. Odnos između Vlade i Skupštine Republike Kosovo (u daljem tekstu</p>
--	---	---

Kosovës (në tekstin e mëtejshëm Kuvendi) e përcaktuar me Kushtetutën e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Kushtetuta) dhe legjislacionin në fuqi, si dhe ndërmjet Qeverisë dhe subjekteve të tjera të përcaktuara me këtë ligj.

Neni 2 Fushëveprimi

Dispozitat e këtij ligji janë të detyrueshme për Kryeministrin, zëvendëskryeministrat, ministrat, zëvendësministrat, të emëruarit e tyre, zyrtarët publikë të administratës shtetërore, si dhe për Zyrën e Kryeministrit, ministritë, agjencitë dhe organet e tjera në vartësi të Qeverisë së Republikës së Kosovës.

Neni 3 Parimet e përgjithshme

1. Qeveria gjatë ushtrimit të pushtetit ekzekutiv udhëhiqet nga këto parime kryesore:

1.1. **Kushtetutshmëria dhe Ligjshmëria** – Qeveria e ushtron pushtetin e saj në pajtim me Kushtetutën dhe ligjin;

1.2. **Të drejtat e njeriut dhe liritë**

Republic of Kosovo (hereinafter the Assembly) defined by the Constitution of the Republic of Kosovo (hereinafter: the Constitution) and the legislation in force, as well as between the Government and other entities defined by this law.

Article 2 Scope

The provisions of this law are mandatory for the Prime Minister, Deputy Prime Ministers, Ministers, Deputy Ministers, their appointees, public officials of the state administration, as well as for the Office of the Prime Minister, ministries, agencies and other bodies subordinate to the Government of the Republic of Kosovo.

Article 3 General principles

1. The government during the exercise of executive power shall be governed by the following main principles:

1.1. **Constitutionality and Legality** - The Government exercises its power in accordance with the Constitution and the law;

1.2. **Human rights and fundamental**

Skupština) definisan Ustavom Republike Kosovo (u daljem tekstu: Ustav) i zakonima na snazi, kao i između Vlade i drugih subjekata definisanih ovim zakonom.

Član 2 Obim

Odredbe ovog zakona obavezne su za predsednika Vlade, potpredsednike Vlade, ministre, zamenike ministara, njihove predstavnike, javne funkcionere državne uprave, kao i za kabinet predsednika Vlade, ministarstva, agencije i druge organe podređene Vladi Republike Kosovo.

Član 3 Opšta načela

1. Vlada se tokom vršenja izvršne vlasti rukovodi sledećim glavnim načelima:

1.1. **Ustavnost i zakonitost** - Vlada vrši svoja ovlašćenja u skladu sa Ustavom i zakonom;

1.2. **Ljudska prava i osnovne**

themelore – Qeveria ushtron pushtetin e saj duke mbrojtur dhe garantuar të drejtat e njeriut dhe liritë themelore siç përcaktohen në Kushtetutë dhe legjislacionin në fuqi;

1.3. Barazia gjinore - Qeveria ushtron pushtetin e saj duke siguruar barazinë gjinore dhe mundësitë e barabarta siç përcaktohet me Kushtetutë dhe legjislacionin në fuqi;

1.4. Transparenca dhe llogaridhënia – puna e Qeverisë është transparente dhe e qasshme për publikun në pajtim me ligjin përkatës për qasje në dokumente publike dhe legjislacionin tjetër në fuqi;

1.5. Efikasiteti dhe efektshmëria - puna e Qeverisë bazohet në zbatimin e përgjegjësive të saj në kohë dhe me kosto sa më të ulët, aq sa është e nevojshme për të arritur qëllimet e saj në mënyrë proporcionale, me përdorim efikas të burimeve publike dhe me qëllim të parandalimit të tepricës së burimeve njerëzore dhe të shpenzimeve të panevojshme;

1.6. Integriteti dhe profesionalizmi – puna e anëtarëve të Qeverisë ushtrohet me integritet të lartë dhe profesionalizëm.

freedoms - The government exercises its power by protecting and guaranteeing human rights and fundamental freedoms as defined in the Constitution and applicable law;

1.3. Gender equality - The Government exercises its power by ensuring gender equality and equal opportunities as defined by the Constitution and the legislation in force;

1.4. Transparency and accountability - the work of the Government is transparent and accessible to the public in accordance with the relevant law on access to public documents and other legislation in force;

1.5. Efficiency and effectiveness - the work of the Government is based on the implementation of its responsibilities in a timely manner and at the lowest possible cost, as far as is necessary to achieve its goals in a proportionate manner, with efficient use of public resources and in order to prevent surplus human resources and unnecessary expenses;

1.6. Integrity and professionalism - the work of members of the Government is exercised with high integrity and professionalism.

slobode - Vlada vrši svoju moć štiteći i garantujući ljudska prava i osnovne slobode definisane Ustavom i važećim zakonom;

1.3. Rodna ravnopravnost - Vlada vrši svoju vlast obezbeđivanjem rodne ravnopravnosti i jednakih mogućnosti definisanih Ustavom i važećim zakonima;

1.4. Transparentnost i odgovornost - rad Vlade je transparentan i dostupan javnosti u skladu sa relevantnim zakonom o pristupu javnim dokumentima i drugim važećim propisima;

1.5. Efikasnost i efektivnost – rad Vlade zasniva se na blagovremenom i po najnižim mogućim troškovima izvršavanju svojih obaveza, koliko je to neophodno za postizanje svojih ciljeva na srazmeran način, uz efikasno korišćenje javnih resursa i u radi sprečavanja viška ljudskih resursa i nepotrebnih troškova;

1.6. Integritet i profesionalnost – rad članova Vlade obavlja se sa visokim integritetom i profesionalnošću.

**KAPITULLI II - PËRBËRJA DHE
FILLIMI I MANDATIT**

**Neni 4
Përbërja e Qeverisë**

1. Qeveria përbëhet nga Kryeministri, zëvendëskryeministrat dhe ministrat.
2. Përbërja e Qeverisë së Kosovës bazohet në përfaqësimin e barabartë gjinor në pajtim me Kushtetutën dhe legjislacionin në fuqi.
3. Përfaqësimi i komuniteteve në përbërjen e Qeverisë bëhet në pajtim me Kushtetutën.
4. Numri i anëtarëve të Qeverisë dhe të emëruarve të tyre, si dhe fushat e përgjegjësisë administrative të ministrive përcaktohen me rregullore të propozuar nga Zyra e Kryeministrit dhe të miratuar nga Qeveria.
5. Numri i anëtarëve të Qeverisë arsyetohet me plotësimin e kritereve të domosdoshmërisë, duke përfshirë në veçanti programin e Qeverisë dhe kompleksitetin e tij, efikasitetin ekonomik, efektivitetin, vlerën për para, parandalimin e tepricës dhe proporcionalitetin.

**CHAPTER II - COMPOSITION AND
BEGINNING OF THE MANDATE**

**Article 4
Composition of the Government**

1. The Government shall be composed of the Prime Minister, deputy prime ministers and ministers.
2. The composition of the Government of Kosovo is based on equal gender representation in accordance with the Constitution and applicable legislation.
3. Representation of communities in the composition of the Government is done in accordance with the Constitution.
4. The number of members of the Government and their appointees, as well as the areas of administrative responsibility of the ministries are determined by regulations proposed by the Office of the Prime Minister and approved by the Government.
5. The number of members of the Government is justified by meeting the criteria of necessity, including in particular the program of the Government and its complexity, economic efficiency, effectiveness, value for money, prevention of surplus and proportionality.

**POGLAVLJE II – SASTAV I
POČETAK MANDATA**

**Član 4
Sastav Vlade**

1. Vladu čine premijer, potpredsednici vlade i ministri.
2. Sastav Vlade Kosova je zasnovan na ravnopravnoj zastupljenosti polova u skladu sa Ustavom i važećim zakonom.
3. Zastupanje zajednica u sastavu Vlade vrši se u skladu sa Ustavom.
4. Broj članova Vlade i njihovih imenovanih, kao i oblasti administrativne odgovornosti ministarstava utvrđuju se propisima koje predlaže Kabinet premijera, a usvaja Vlada.
5. Broj članova Vlade opravdava se ispunjavanjem kriterijuma neophodnosti, uključujući posebno program Vlade i njegovu složenost, ekonomsku efikasnost, efektivnost, vrednost za novac, sprečavanje viška i proporcionalnost.

<p style="text-align: center;">Neni 5 Kushtet për zgjedhjen e anëtarëve të Qeverisë</p> <p>1. Anëtarë të Qeverisë zgjedhen personat të cilët plotësojnë kushtet si në vijim:</p> <p>1.1. Shtetasit e Republikës së Kosovës të moshës madhore, të cilët kanë aftësi të plotë të veprimit;</p> <p>1.2. Personat nga radha e deputetëve të Kuvendit apo persona të kualifikuar;</p> <p>1.3. Personat të cilëve nuk u është kufizuar kjo e drejtë me vendim gjyqësor të formës së prerë.</p> <p>2. Kushtet e parapara me paragrafin 1 të këtij neni zbatohen edhe për emërimin e zëvendësministrave.</p>	<p style="text-align: center;">Article 5 Conditions for the election of members of the Government</p> <p>1. Persons who meet the following conditions shall be elected members of the Government:</p> <p>1.1. Adult citizens of the Republic of Kosovo, who have full legal capacity;</p> <p>1.2. Persons from the ranks of members of the Assembly or qualified persons;</p> <p>1.3. Persons to whom this right has not been restricted by a final court decision.</p> <p>2. The conditions provided for in paragraph 1 of this Article shall also apply to the appointment of Deputy Ministers.</p>	<p style="text-align: center;">Član 5 Uslovi za izbor članova Vlade</p> <p>1. Za članove Vlade biraju se lica koja ispunjavaju sledeće uslove:</p> <p>1.1. Punoletni državljani Republike Kosovo, koji imaju punu poslovnu sposobnost;</p> <p>1.2. Lica iz reda članova Skupštine ili kvalifikovana lica;</p> <p>1.3. Lica kojima ovo pravo nije ograničeno pravosnažnom sudskom odlukom.</p> <p>2. Uslovi iz stava 1. ovog člana primenjuju se i na imenovanje zamenika ministara.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 6 Fillimi i mandatit</p> <p>1. Mandati i Qeverisë fillon me zgjedhjen e Qeverisë nga Kuvendi i Republikës së Kosovës.</p> <p>2. Anëtarët e Qeverisë, pas zgjedhjes, japin betimin para Kuvendit të Republikës së Kosovës, duke lexuar tekstin në vijim:</p> <p><i>“Beto hem se do ta kryej me përkushtim dhe</i></p>	<p style="text-align: center;">Article 6 Beginning of the mandate</p> <p>1. The mandate of the Government begins with the election of the Government by the Assembly of the Republic of Kosovo.</p> <p>2. The members of the Government, after the election, take the oath before the Assembly of the Republic of Kosovo, by reading the following text:</p> <p><i>"I do swear that I will discharge the duty of</i></p>	<p style="text-align: center;">Član 6 Početak mandata</p> <p>1. Mandat Vlade počinje izborom Vlade od strane Skupštine Republike Kosovo.</p> <p>2. Članovi Vlade, nakon izbora, polažu zakletvu pred Skupštinom Republike Kosovo čitajući sledeći tekst:</p> <p><i>„Kunem se da ću predano obavljati i</i></p>

nder detyrën e anëtarit të Qeverisë, do të respektoj Kushtetutën, ligjet dhe rendin juridik dhe do të angazhohem për përparimin e përgjithshëm të Republikës së Kosovës.”

3. Deklarata e betimit, përveç tekstit nga paragrafi 2 i këtij neni, përmban emrin, mbiemrin, datën dhe nënshkrimin e anëtarit të Qeverisë që është betuar.

**Neni 7
Programi i Qeverisë**

Qeveria përcakton orientimet themelore të politikave qeveritare gjatë mandatit të saj, përmes miratimit të Programit të Qeverisë, i cili publikohet në ueb-faqen zyrtare të Zyrës së Kryeministrit.

**KAPITULLI III - MËNYRA E
FUNKSIONIMIT DHE
KOMPETENCAT E QEVERISË**

**Neni 8
Kompetencat e Qeverisë**

1. Qeveria ushtron pushtetin ekzekutiv në përputhje me Kushtetutën dhe legjislacionin në fuqi.

the member of the Government with commitment and honour, I will respect the Constitution, laws and legal order and that I will commit to the overall progress of the Republic of Kosovo.”

3. The declaration of oath, in addition to the text referred to in paragraph 2 of this Article, shall contain the name, surname, date and signature of the member of the Government who has taken the oath.

**Article 7
Program of the Government**

The Government determines the basic orientations of government policies during its mandate, through the approval of the Government Program, which is published on the official website of the Office of the Prime Minister.

**CHAPTER III - FUNCTIONING AND
COMPETENCES OF THE
GOVERNMENT**

**Article 8
Competencies of the Government**

1. The government shall exercise executive power in accordance with the Constitution and applicable legislation.

poštovati dužnost člana Vlade, poštovaću Ustav, zakone i pravni poredak i da ću biti posvećen sveukupnom napretku Republike Kosovo.

3. Izjava o zakletvi, pored teksta iz stava 2. ovog člana, sadrži ime, prezime, datum i potpis člana Vlade koji je položio zakletvu.

**Član 7
Vladin program**

Vlada utvrđuje osnovne orijentacije vladinih politika tokom svog mandata, usvajanjem Programa Vlade, koji se objavljuje na zvaničnoj internet stranici Kabineta premijera.

**Poglavlje III – NAČIN
FUNKCIONISANJA I NADLEŽNOSTI
VLADE**

**Član 8
Nadležnosti Vlade**

1. Vlada vrši izvršnu vlast u skladu sa Ustavom i važećim zakonom.

<p>2. Anëtarët e Qeverisë, përveç kompetencave të përcaktuara me Kushtetutë, këtë ligj dhe legjislacionin tjetër në fuqi, informojnë Kryeministrin dhe Qeverinë në tërësi, për masat e ndërmarra në zbatimin e vendimeve të tyre, apo të Qeverisë, si dhe zbatimin e Planit të Punës së Qeverisë për sa i përket fushave të tyre të përgjegjësisë.</p> <p>3. Qeveria në mbledhjet e saj shqyrton, debaton dhe vendos për propozimet, të cilat janë përgatitur në pajtim me Rregulloren e Punës së Qeverisë.</p> <p>4. Në ushtrimin e pushtetit të saj ekzekutiv të përcaktuar në Kushtetutë, Qeveria ushtron përgjegjësitë e mëposhtme:</p> <p>4.1. I propozon Kuvendit projekt amendamente kushtetuese dhe projektligje;</p> <p>4.2. Merr vendim për iniciimin e marrëveshjeve ndërkombëtare;</p> <p>4.3. Mund të jep mendim për nismat legislative dhe projekt amendamentet kushtetuese, inicues i të cilave nuk është Qeveria;</p> <p>4.4. Propozon dhe zbaton politikën e jashtme të vendit;</p>	<p>2. Members of the Government, in addition to the competencies set out in the Constitution, this law, and other applicable legislation shall inform the Prime Minister and the Government as a whole, of the measures taken to implement their decisions, or those of the Government, and the implementation of the Government Work Plan in terms of their areas of responsibility.</p> <p>3. At its meetings, the Government shall review, debate, and decide on the proposals, which have been prepared in accordance with the Rules of Procedure of the Government.</p> <p>4. In exercising its executive power set forth in the Constitution, the Government shall exercise the following responsibilities:</p> <p>4.1. Propose draft constitutional amendments and draft laws to the Assembly;</p> <p>4.2. Decide on the initiation of international agreements;</p> <p>4.3. Can give an opinion on legislative initiatives and draft constitutional amendments, which are not initiated by the Government;</p> <p>4.4. Propose and implement the foreign policy of the country;</p>	<p>2. Članovi Vlade, pored nadležnosti utvrđenih Ustavom, ovim zakonom i drugim zakonima na snazi, obaveštavaju predsednika Vlade i Vladu u celini, o preduzetim merama u sprovođenju svojih odluka, odnosno Vladu, kao kao i sprovođenje Plana rada Vlade u pogledu svojih nadležnosti.</p> <p>3. Vlada na sednicama razmatra, raspravlja i odlučuje o predlozima koji se pripremaju u skladu sa Poslovníkom Vlade.</p> <p>4. U vršenju svoje izvršne vlasti utvrđene Ustavom, Vlada vrši sledeće nadležnosti:</p> <p>4.1. Predlaže Skupštini nacrt ustavnih amandmana i nacrt zakona;</p> <p>4.2. Odlučuje o pokretanju međunarodnih ugovora;</p> <p>4.3. Može da daje mišljenje o zakonodavnim inicijativama i nacrtima ustavnih amandmana koje nije inicirala Vlada;</p> <p>4.4. Predlaže i sprovodi spoljnu politiku zemlje;</p>
--	---	---

4.5. Merr vendime dhe nxjerr akte të tjera juridike të nevojshme për zbatimin e ligjeve;

4.6. Vendos për emërimet dhe shkarkimet brenda kompetencave të veta ligjore;

4.7. Miraton dokumente strategjike dhe plane të ndryshme në zbatim të ligjeve e politikave të Qeverisë;

4.8. Miraton koncept dokumente, vlerësime ex post të legjislacionit dhe dokumente të tjera të politikave;

4.9. Miraton raportin vjetor mbi punën e vet dhe raporte periodike mbi zbatimin e politikave, ligjeve dhe akteve nënligjore;

4.10. Kryen edhe detyra të tjera të përcaktuara me Kushtetutë dhe me legjislacionin në fuqi.

**Neni 9
Kompetencat e Kryeministrit**

1. Kryeministri, në cilësinë e përfaqësuesit dhe udhëheqësit të Qeverisë, brenda kufijve të kompetencave të përcaktuara në Kushtetutë, ushtron përgjegjësitë e mëposhtme:

4.5. Make decisions and issue other legal acts necessary for the implementation of laws;

4.6. Decide on appointments and dismissals within its legal competencies;

4.7. Approve various strategic documents and plans implementation of Government laws and policies;

4.8. Approve concept documents, ex post legislation assessments and other policy documents;

4.9. Approve the annual report on its work and periodic reports on the implementation of policies, laws and bylaws;

4.10. Perform other duties defined by the Constitution and the legislation in force.

**Article 9
Competencies of the Prime Minister**

1. The Prime Minister, in the capacity of representative and leader of the Government, within the limits of the competencies defined in the Constitution, shall exercise the following responsibilities:

4.5. Donosi odluke i donosi druge pravne akte neophodne za sprovođenje zakona;

4.6. Odlučuje o imenovanjima i razrešenjima u okviru svojih zakonskih nadležnosti;

4.7. Odobrava različite strateške dokumente i planove u skladu sa zakonima i politikom Vlade;

4.8. Odobrava koncept papire, ex post procene zakonodavstva i druge dokumente politike;

4.9. Usvaja godišnji izveštaj o svom radu i periodične izveštaje o sprovođenju politika, zakona i podzakonskih akata;

4.10. Obavlja i druge poslove utvrđene Ustavom i važećim zakonima.

**Član 9
Ovlašćenja premijera**

1. Predsednik Vlade, u svojstvu predstavnika i rukovodioca Vlade, u granicama nadležnosti utvrđenih Ustavom, obavlja sledeće dužnosti:

<p>1.1. Bashkërendon dhe mbikëqyrë punën e anëtarëve të tjerë të Qeverisë;</p> <p>1.2. Kryen të gjitha veprimet përkatëse për lidhjen e marrëveshjeve ndërkombëtare dhe e njofton Kuvendin në përputhje me Kushtetutën dhe ligjin;</p> <p>1.3. Nxjerr vendime, urdhëra, dekrete dhe lidh marrëveshje mirëkuptimi;</p> <p>1.4. Emëron dhe shkarkon nga detyra zëvendëskryeministrat, ministrat, zëvendësministrat dhe zyrtarët e tjerë publik në pajtim me legjislacionin në fuqi;</p> <p>1.5. Kërkon nga çdonjëri prej zëvendëskryeministrave, ministrave dhe zëvendësministrave që t'i ofrojë informata dhe raporte nga fusha e vet e përgjegjësisë dhe për mbarëvajtjen e punës së Qeverisë;</p> <p>1.6. Përjashtimisht, nëse vlerëson se vendimi i marrë nga Qeveria mund të ketë pasoja të dëmshme apo është i kundërligjshëm, në mbledhjen e radhës kërkon që Qeveria ta rishyrtojë dhe ta ndryshojë vendimin e saj.</p> <p>1.7. Nëse vlerëson se vendimi i marrë apo akti nënligjor i nxjerrë nga zëvendëskryeministri apo ministri mund të ketë pasoja të dëmshme apo është i kundërligjshëm, menjëherë kërkon që të</p>	<p>1.1. Coordinate and supervise the work of other members of the Government;</p> <p>1.2. Perform all relevant actions for the conclusion of international agreements and notifies the Assembly in accordance with the Constitution and the law;</p> <p>1.3. Issue decisions, orders, decrees and enter into memoranda of understanding;</p> <p>1.4. Appoint and dismiss Deputy Prime Ministers, Ministers, Deputy Ministers and other public officials in accordance with applicable law;</p> <p>1.5. Request from each of the Deputy Prime Ministers, Ministers and Deputy Ministers to provide information and reports from their area of responsibility and for the progress of the work of the Government;</p> <p>1.6. Exceptionally, if he/she deems that the decision taken by the Government may have harmful consequences or is illegal, at the next meeting it requests that the Government reconsider and change its decision.</p> <p>1.7. If he/she deems that the decision taken or the sub-legal act issued by the Deputy Prime Minister or the Minister may have harmful consequences or is illegal, he/she immediately requests to</p>	<p>1.1. Koordinira i nadzire rad ostalih članova Vlade;</p> <p>1.2. Vršiti sve relevantne radnje za zaključivanje međunarodnih ugovora i obaveštava Skupštinu u skladu sa Ustavom i zakonom;</p> <p>1.3. Izdaje odluke, naredbe, uredbe i sklapa memorandume o razumevanju;</p> <p>1.4. Imenuje i razrešava potpredsednike Vlade, ministre, zamenike ministara i druge javne funkcionere u skladu sa važećim zakonom;</p> <p>1.5. Zahteva od svakog od potpredsednika, ministara i zamenika ministara da daju informacije i izveštaje iz svoje nadležnosti i za napredak u radu Vlade;</p> <p>1.6. Izuzetno, ako smatra da odluka koju je donela Vlada može imati štetne posledice ili je nezakonita, na narednoj sednici zahteva od Vlade da preispita i promeni svoju odluku.</p> <p>1.7. Ako smatra da doneta odluka ili podzakonski akt zamenika premijera ili ministra može imati štetne posledice ili je nezakonit, odmah traži da se ista ukine, u suprotnom odlučuje da se</p>
---	--	--

<p>njëjtin t'a shfuqizojë, në të kundërtën, merr vendim për anulimin apo shfuqizimin e tij;</p> <p>1.8. I raporton Kuvendit në mënyrë periodike apo sipas kërkesës së Kuvendit, për aktivitetet e Qeverisë;</p> <p>1.9. Siguron se ka komunikim efektiv të politikave dhe të aktiviteteve qeveritare për qytetarët e Republikës së Kosovës;</p> <p>1.10. Nënshkruan të gjitha vendimet e marra si dhe rregulloret dhe aktet e tjera juridike të nxjerra nga Qeveria dhe mbikëqyrë zbatimin e tyre;</p> <p>1.11. Kryen detyra të tjera në pajtim me Kushtetutën dhe legjislacionin në fuqi.</p>	<p>repeal it, otherwise, takes a decision for its annulment or abrogation;</p> <p>1.8. Report to the Assembly periodically or at the request of the Assembly, on the activities of the Government;</p> <p>1.9. Ensure that there is effective communication of government policies and activities for the citizens of the Republic of Kosovo;</p> <p>1.10. Sign all decisions taken, including regulations and other legal acts issued by the Government and supervise their implementation;</p> <p>1.11. Perform other duties in accordance with the Constitution and applicable law.</p>	<p>poništi ili ukine;</p> <p>1.8. Izvještava Skupštinu periodično ili na zahtjev Skupštine o radu Vlade;</p> <p>1.9. Osigurava da postoji efikasna komunikacija vladinih politika i aktivnosti za građane Republike Kosovo;</p> <p>1.10. Potpisuje sve donete odluke, kao i propise i druge zakonske akte koje donosi Vlada i nadzire njihovo sprovođenje;</p> <p>1.11. Obavlja i druge poslove u skladu sa Ustavom i važećim zakonom.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 10 Kompetencat e zëvendëskryeministrave</p> <p>1. Zëvendëskryeministri gjatë ushtrimit të kompetencave të tij:</p> <p>1.1. Ndhmon Kryeministrin në caktimin e prioriteteve, në zhvillimin dhe zbatimin e politikave të Qeverisë;</p> <p>1.2. Me autorizim të Kryeministrit, mund t'i delegohen përgjegjësi që me ligj i janë dhënë Kryeministrit;</p>	<p style="text-align: center;">Article 10 Competencies of Deputy Prime Ministers</p> <p>1. The Deputy Prime Minister during the exercise of his competencies shall:</p> <p>1.1. Assist the Prime Minister in setting priorities, developing and implementing Government policies;</p> <p>1.2. With the authorization of the Prime Minister, he/she may be delegated responsibilities given to the Prime</p>	<p style="text-align: center;">Član 10 Ovlašćenja potpredsednika vlade</p> <p>1. Potpredsednik Vlade za vreme vršenja svojih ovlašćenja:</p> <p>1.1. Pomaže premijeru u određivanju prioriteta, razvoju i sprovođenju vladinih politika;</p> <p>1.2. Uz ovlašćenje premijera, dužnosti se mogu poveriti predsedniku vlade zakonom;</p>

<p>1.3. Me vendim të Kryeministrit mund të marrin përgjegjësi për koordinimin e një fushe me rëndësi të veçantë dhe prioritet të lartë për Qeverinë, duke përfshirë edhe koordinimin e një fushe të politikave që është në kuadër të përgjegjësisë së disa ministrive;</p> <p>1.4. Zëvendëskryeministrit mund t'i jepet mandati për një ministri, me ç'rast ai mban dy sferat e përgjegjësisë administrative të veçanta;</p> <p>1.5. Zëvendëskryeministri informon paraprakisht Kryeministrin për vizitat jashtë vendit dhe i raporton me shkrim apo me gojë, jo më vonë se pesë (5) ditë pas realizimit të tyre;</p> <p>1.6. Ushtron detyra të tjera të cilat u caktohen nga Kryeministri.</p> <p>2. Autorizimi sipas nënparagrafit 1.2. dhe vendimi sipas nënparagrafit 1.3. të këtij neni bëhen publike në faqen zyrtare të Zyrës së Kryeministrit.</p> <p>3. Në rast se Qeveria në përbërjen e saj ka më shumë se një zëvendëskryeministër, njëri nga Zëvendëskryeministrat emërohet Zëvendëskryeministër i parë.</p>	<p>Minister by law;</p> <p>1.3. By decision of the Prime Minister, they can take responsibility for the coordination of an area of special importance and high priority for the Government, including the coordination of a policy area that is within the responsibility of several ministries;</p> <p>1.4. The Deputy Prime Minister may be given the mandate for a ministry, in which case he holds two separate areas of administrative responsibility;</p> <p>1.5. The Deputy Prime Minister informs the Prime Minister in advance about the visits abroad and reports about them in writing or verbally, no later than five (5) days after their occurrence;</p> <p>1.6. Exercise other tasks assigned to them by the Prime Minister.</p> <p>2. Authorization according to sub-paragraph 1.2. and the decision under subparagraph 1.3. of this Article are made public on the official website of the Office of the Prime Minister.</p> <p>3. In case the Government has more than one Deputy Prime Minister in its composition, one of the Deputy Prime Ministers is appointed as the First Deputy Prime Minister.</p>	<p>1.3. Odlukom premijera mogu preuzeti odgovornost za koordinaciju oblasti od posebnog značaja i visokog prioriteta za Vladu, uključujući koordinaciju oblasti politike koja je u nadležnosti više ministarstava;</p> <p>1.4. Zameniku premijera može se dati mandat za ministarstvo, u kom slučaju on ima dve odvojene oblasti administrativne odgovornosti;</p> <p>1.5. Potpredsednik Vlade unapred obaveštava predsednika Vlade o posetama inostranstvu i izveštava ih pismeno ili usmeno, najkasnije pet (5) dana od njihove realizacije;</p> <p>1.6. Obavlja i druge poslove koje im poveri predsednik Vlade.</p> <p>2. Ovlašćenje prema podstavu 1.2. i odluku iz podstav 1.3. ovog člana objavljuju se na zvaničnoj internet stranici Kabineta predsednika Vlade.</p> <p>3. U slučaju da Vlada u svom sastavu ima više od jednog potpredsednika Vlade, za prvog potpredsednika imenuje se jedan od potpredsednika Vlade.</p>
---	---	--

4. Në rast se Kryeministri mungon, atë e zëvendëson Zëvendëskryeministri i parë ose një Zëvendëskryeministër tjetër i autorizuar me shkrim nga Kryeministri.

5. Në rast se Kryeministri dhe Zëvendëskryeministrat mungojnë, Kryeministri autorizon me shkrim njërin nga ministrat për zëvendësimin e përkohshëm të tij.

Neni 11 Kompetencat e ministrave

1. Ministri, gjatë ushtrimit të kompetencave të tij:

1.1. Udhëheq dhe përfaqëson ministrinë;

1.2. Propozon procesin e nismës së marrëveshjes ndërkombëtare, në pajtim me procedurat ligjore në fuqi për lidhjen e marrëveshjeve ndërkombëtare brenda fushës së përgjegjësisë administrative të Ministrisë;

1.3. Propozon projektligje, akte nënligjore, koncept dokumente, vlerësime ex-post të legjislacionit, projekt dokumente strategjike dhe raporte të ndryshme për miratim në Qeveri;

1.4. Siguron zbatimin e legjislacionit

4. In case the Prime Minister is absent, he shall be replaced by the First Deputy Prime Minister or another Deputy Prime Minister authorized in writing by the Prime Minister.

5. In case the Prime Minister and the Deputy Prime Ministers are absent, the Prime Minister authorizes in writing one of the ministers for his temporary replacement.

Article 11 Competencies of ministers

1. The Minister, during the exercise of his competencies shall:

1.1. Lead and represent the ministry;

1.2. Propose the process for the initiation an international agreement, in accordance with the legal procedures in force for concluding international agreements within the scope of administrative responsibility of the Ministry;

1.3. Propose draft laws, bylaws, concept documents, ex-post evaluations of legislation, draft strategic documents and various reports for approval by the Government;

1.4. Ensure the implementation of

4. U slučaju da je premijer odsutan, zamenjuje ga prvi potpredsednik Vlade ili drugi potpredsednik Vlade koga pismeno ovlasti premijer.

5. U slučaju odsustva predsednika Vlade i potpredsednika Vlade, predsednik Vlade pismeno ovlašćuje jednog od ministara za njegovu privremenu zamenu.

Član 11 Nadležnosti ministara

1. Ministar u vršenju svojih nadležnosti:

1.1. Vodi i predstavlja ministarstvo;

1.2. Predlaže postupak pokretanja međunarodnog ugovora, u skladu sa zakonskim procedurama koje su na snazi za zaključenje međunarodnih ugovora iz delokruga upravne odgovornosti Ministarstva;

1.3. Predlaže nacрте zakona, podzakonskih akata, koncept dokumente, ek-post evaluacije zakonodavstva, nacрте strateških dokumenata i različite izveštaje na usvajanje od strane Vlade;

1.4. Obezbeđuje sprovođenje vladinog

<p>dhe politikave qeveritare nga fushëveprimi i ministrisë;</p> <p>1.5. Merr vendime dhe nxjerr akte të tjera juridike nga fushëveprimi ministrisë të nevojshme për zbatimin e ligjeve;</p> <p>1.6. Merr pjesë në mbledhjet e Qeverisë dhe të trupave punuese të saj;</p> <p>1.7. Propozon zgjidhje për çështje të veçanta në kompetencë të Qeverisë;</p> <p>1.8. Siguron planifikim të qartë të buxhetit dhe formulon prioritetet për ndarjen e mjeteve financiare, që i vihen në dispozicion nga Buxheti i Kosovës dhe nga burime të tjera;</p> <p>1.9. Informon paraprakisht Kryeministrin për vizitat jashtë vendit dhe raporton me shkrim apo me gojë, jo më vonë se pesë (5) ditë pas realizimit të tyre;</p> <p>1.10. Njofton paraprakisht Kryeministrin dhe Qeverinë për organizimin e ngjarjeve të rëndësishme dhe raporton me shkrim, jo më vonë se pesë (5) ditë pas mbarimit të tyre;</p> <p>1.11. I raporton Kryeministrit dhe Qeverisë në mënyrë periodike, apo me kërkesë të Kryeministrit, për aktivitetet e ministrisë;</p>	<p>government legislation and policies within the scope of the ministry;</p> <p>1.5. Make decisions and issue other legal acts within the scope of the ministry necessary for the implementation of laws;</p> <p>1.6. Participate in the meetings of the Government and its working bodies;</p> <p>1.7. Propose solutions to specific issues within the competence of the Government;</p> <p>1.8. Provide clear budget planning and formulate priorities for the allocation of funds, which are made available from the Kosovo Budget and other sources;</p> <p>1.9. Inform the Prime Minister in advance about the visits abroad and reports in writing or verbally, no later than five (5) days after their occurrence;</p> <p>1.10. Notify the Prime Minister and the Government in advance of the organization of important events and report in writing, no later than five (5) days after their completion;</p> <p>1.11. Report to the Prime Minister and the Government periodically, or at the request of the Prime Minister, on the activities of the ministry;</p>	<p>zakonodavstva i politika iz delokruga ministarstva;</p> <p>1.5. Donosi odluke i donosi druga pravna akta iz delokruga ministarstva neophodna za sprovođenje zakona;</p> <p>1.6. Učestvuje na sednicama Vlade i njenih radnih tela;</p> <p>1.7. Predlaže rešenja za pojedina pitanja iz nadležnosti Vlade;</p> <p>1.8. Obezbeđuje jasno planiranje budžeta i formuliše prioritete za raspodelu sredstava koja su mu stavljena na raspolaganje iz budžeta Kosova i drugih izvora;</p> <p>1.9. Unapred obaveštava predsednika Vlade o posetama inostranstvu i izveštava pismeno ili usmeno, najkasnije pet (5) dana od njihove realizacije;</p> <p>1.10. Obaveštava premijera i Vladu unapred o organizovanju važnih događaja i izveštajima u pisanoj formi, najkasnije pet (5) dana nakon njihovog završetka;</p> <p>1.11. Izveštava premijera i Vladu periodično, ili na zahtev predsednika Vlade, o radu ministarstva;</p>
--	--	---

<p>1.12. I përgjigjet Kryeministrit dhe i raporton Kuvendit për çështjet që kanë të bëjnë me ministrinë që udhëheqë;</p> <p>1.13. Siguron konsultimin me institucionet përkatëse dhe palët e tjera të interesit si dhe koordinimin me Zyrën e Kryeministrit në procesin e përgatitjes së legjislacionit dhe politikave nga fushëveprimi i ministrisë;</p> <p>1.14. Kryen detyra të tjera brenda fushës së përgjegjësisë së ministrisë, të përcaktuara me legjislacionin tjetër në fuqi.</p> <p>2. Ministri ushtron edhe detyra të tjera me të cilat ngarkohen nga Qeveria ose nga Kryeministri në pajtim me legjislacionin në fuqi.</p> <p style="text-align: center;">Neni 12 Emërimi dhe kompetencat e zëvendësministrave</p> <p>1. Zëvendësministri emërohet nga Kryeministri për mbështetjen e ministrit.</p> <p>2. Me rastin e emërimit të zëvendësministrave merret parasysh neni 96, paragrafi 4 i Kushtetutës.</p> <p>3. Kryeministri mund të emërojë deri në 2</p>	<p>1.12. Respond to the Prime Minister and report to the Assembly on issues related to the ministry he/she leads;</p> <p>1.13. Provide consultation with relevant institutions and other stakeholders as well as coordination with the Office of the Prime Minister in the process of preparing legislation and policies within the scope of the ministry;</p> <p>1.14. Perform other duties within the area of responsibility of the ministry, defined by other legislation in force.</p> <p>2. The Minister also exercises other duties which are assigned by the Government or by the Prime Minister in accordance with the legislation in force.</p> <p style="text-align: center;">Article 12 Appointment and competencies of deputy ministers</p> <p>1. The deputy minister shall be appointed by the Prime Minister for the support of the Minister.</p> <p>2. When appointing deputy ministers, Article 96, paragraph 4 of the Constitution is taken into account.</p> <p>3. The Prime Minister may appoint up to 2</p>	<p>1.12. Polaže račune premijeru i izveštava Skupštinu o pitanjima u vezi sa ministarstvom koje vodi;</p> <p>1.13. Obezbeđuje konsultacije sa relevantnim institucijama i drugim zainteresovanim stranama, kao i koordinaciju sa Kancelarijom premijera u procesu pripreme zakona i politika iz delokruga ministarstva;</p> <p>1.14. Obavlja i druge poslove iz delokruga ministarstva, utvrđene drugim važećim propisima.</p> <p>2. Ministar vrši i druge dužnosti koje mu odredi Vlada ili Premijer u skladu sa zakonima na snazi.</p> <p style="text-align: center;">Član 12 Imenovanje i ovlašćenja zamenika ministara</p> <p>1. Zamenika ministra imenuje predsednik Vlade za podršku ministru.</p> <p>2. Prilikom imenovanja zamenika ministara vodi se računa o članu 96. stav 4. Ustava.</p> <p>3. Predsednik Vlade može imenovati do 2</p>
---	---	---

<p>zëvendësministra për një ministri. Kur Kryeministri emëron më shumë se një (1) zëvendësministër për një ministri, njërin nga ta e emëron zëvendësministër të parë.</p> <p>4. Në rast se posti i ministrit mbetet i lirë për cilëndo arsye të përcaktuar me këtë ligj, zëvendësministri i parë, respektivisht, zëvendësministri në rastet kur ministria ka vetëm një zëvendësministër, ushtron detyrën e ministrit, deri në emërimin e ministrit të ri.</p> <p>5. Zëvendësministri, gjatë ushtrimit të kompetencave të tij është përgjegjës për menaxhimin e aktiviteteve në fushat e përcaktuara nga ministri përkatës, si dhe:</p> <p>5.1. Me njoftimin paraprak të Kryeministrit nga ana e Ministrit, mund të merr pjesë në mbledhjen e Qeverisë së Republikës së Kosovës;</p> <p>5.2. Ndihmon ministrin në caktimin e prioriteteve, në zhvillimin dhe zbatimin e politikave të ministrisë;</p> <p>5.3. Me autorizim me shkrim të ministrit, mund t'i delegohen përgjegjësi të caktuara që me ligj i janë dhënë ministrit;</p> <p>5.4. Zëvendësministri i raporton ministrit në baza të rregullta, ndërsa</p>	<p>deputy ministers for one ministry. When the Prime Minister appoints more than one (1) Deputy Minister for a ministry, he appoints one of them as the First Deputy Minister.</p> <p>4. In case the post of the Minister remains vacant for any reason defined by this law, the first deputy minister, respectively, the deputy minister in cases when the ministry has only one deputy minister, shall exercise the duty of minister, until the appointment of the new minister.</p> <p>5. The deputy minister, during the exercise of his/her competencies is responsible for the management of activities in the areas defined by the relevant minister, as well as:</p> <p>5.1. Upon prior notification of the Prime Minister by the Minister, he/she can participate in the meeting of the Government of the Republic of Kosovo;</p> <p>5.2. Assists the minister in setting priorities, developing and implementing ministry policies;</p> <p>5.3. Upon written authorization of the Minister, he/she may be delegated certain responsibilities assigned to the Minister by law;</p> <p>5.4. The deputy minister reports to the Minister on a regular basis, and to the</p>	<p>zamenika ministra za jedno ministarstvo. Kada predsednik Vlade imenuje više od jednog (1) zamenika ministra za ministarstvo, on imenuje jednog od njih za prvog zamenika ministra.</p> <p>4. U slučaju da mesto ministra iz bilo kog razloga utvrđenog ovim zakonom ostane upražnjeno, dužnost ministra vrši prvi zamenik ministra, odnosno zamenik ministra u slučajevima kada ministarstvo ima samo jednog zamenika ministra, do imenovanja novog ministra.</p> <p>5. Zamenik ministra, u vršenju svojih nadležnosti, odgovoran je za rukovođenje poslovima u oblastima koje odredi resorni ministar, kao i:</p> <p>5.1. Uz prethodno obaveštenje premijera od strane ministra, može učestvovati na sednici Vlade Republike Kosovo;</p> <p>5.2. Pomaže ministru u određivanju prioriteta, razvoju i sprovođenju politika ministarstva;</p> <p>5.3. Uz pismeno ovlašćenje ministra, određene odgovornosti mogu se poveriti ministru zakonom;</p> <p>5.4. Zamenik ministra redovno izveštava ministra, a premijera svakih</p>
--	--	--

<p>Kryeministrit çdo gjashtë (6) muaj, nëse një gjë e tillë nuk kërkohet më herët; dhe</p> <p>5.5. Ushtron detyra të tjera të cilat i caktohen nga ministri.</p> <p>6. Autorizimet sipas paragrafit 5 nënparagrafi 5.3 të këtij neni bëhen publike në faqen zyrtare të Ministrisë përkatëse.</p> <p>7. Dispozitat e këtij ligji që kanë të bëjnë me anëtarët e Qeverisë, zbatohen përshtatshëmrisht edhe për zëvendësministrat.</p> <p style="text-align: center;">Neni 13 Këshilltarët politikë të anëtarëve të Qeverisë</p> <p>1. Çdo anëtar i Qeverisë ka kabinetin politik, i cili përbëhet nga këshilltarët politik, këshilltarët e jashtëm dhe nëpunësit në kabinete.</p> <p>2. Këshilltari politik emërohet me vendim drejtpërdrejt nga Kryeministri, zëvendëskryeministri dhe ministri, (në tekstin e mëtejshëm: eprori) dhe i pushon mandati me përfundimin e mandatit të eprorit të tyre, nëse kjo marrëdhënie e punës nuk ndërpritet më herët.</p>	<p>Prime Minister every six (6) months, unless requested to do so earlier; and</p> <p>5.5. Exercises other tasks assigned to him/her by the Minister.</p> <p>6. The authorizations according to paragraph 5 sub-paragraph 5.3 of this Article are made public on the official website of the respective Ministry.</p> <p>7. The provisions of this law relating to members of the Government shall apply mutatis mutandis to the Deputy Ministers.</p> <p style="text-align: center;">Article 13 Political advisors to members of the Government</p> <p>1. Each member of the Government has a political cabinet, which consists of political advisors, external advisors and cabinet officials.</p> <p>2. The political advisor is appointed directly by decision of the Prime Minister, the Deputy Prime Minister and the Minister, (hereinafter: the line manager) and their mandate is terminated upon the expiration of the term of their line manager, if this employment relationship is not terminated earlier.</p>	<p>šest (6) meseci, ako to nije potrebno unapred; i</p> <p>5.5. Obavlja i druge poslove koje mu poveri ministar.</p> <p>6. Ovlašćenja prema stavu 5 podstav 5.3 ovog člana objavljuju se na zvaničnom sajtu nadležnog ministarstva.</p> <p>7. Odredbe ovog zakona koje se odnose na članove Vlade shodno se primenjuju i na zamenike ministara.</p> <p style="text-align: center;">Član 13 Politički savetnici članova Vlade</p> <p>1. Svaki član Vlade ima politički kabinet koji čine politički savetnici, spoljni savetnici i službenici kabineta.</p> <p>2. Političkog savetnika odlukom neposredno postavljaju predsednik Vlade, potpredsednik Vlade i ministar (u daljem tekstu: pretpostavljeni) i prestaje mu mandat istekom mandata pretpostavljenog, ako ovaj radni odnos nije prestao ranije. .</p>
---	---	--

<p>3. Këshilltari politik ofron këshilla për eprorin e tij, mbi bazën e analizimit dhe vlerësimin të politikave me qëllim të arritjes së objektivave qeverisëse të përcaktuara me Programin e Qeverisë dhe me dokumentet e tjera të politikave. Këshilltari politik i përgjigjet eprorit të tij.</p> <p>4. Këshilltari politik duhet siguruar që shërbimi civil zbaton politikat dhe programin e miratuar të Qeverisë.</p> <p>5. Me vendimin për emërimin e Këshilltarit politik, eprori ia cakton edhe fushën e ofrimit të këshilldhënies politike.</p> <p>6. Këshilltar politik emërohet personi i cili plotëson kushtet si në vijim:</p> <p>6.1. Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës;</p> <p>6.2. Të jetë i moshës madhore dhe të ketë aftësi të plotë të veprimit;</p> <p>6.3. Të jetë i kualifikuar dhe me përvojë profesionale;</p> <p>6.4. Të mos jetë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë.</p> <p>7. Këshilltari politik nuk mund të:</p>	<p>3. The political advisor provides advice to his line manager, based on policy analysis and evaluation in order to achieve the governance objectives set out in the Government Program and other policy documents. The political advisor reports to his/her line manager.</p> <p>4. The political advisor must ensure that the civil service implements the approved policies and program of the Government.</p> <p>5. With the decision for the appointment of the Political Advisor, the line manager shall assign him/her the field of providing political advice.</p> <p>6. A person who meets the following conditions shall be appointed political advisor:</p> <p>6.1. To be a citizen of the Republic of Kosovo;</p> <p>6.2. To be of legal age and have full capacity for action;</p> <p>6.3. To be qualified and professionally experienced;</p> <p>6.4. Not convicted by a final court decision.</p> <p>7. The political advisor cannot:</p>	<p>3. Politički savetnik daje savete svom nadređenom, na osnovu analize i evaluacije politike u cilju postizanja ciljeva upravljanja utvrđenih u Programu Vlade i drugim dokumentima politike. Politički savetnik je odgovoran svom pretpostavljenom.</p> <p>4. Politički savetnik mora da obezbedi da civilna služba sprovedi odobrene politike i program Vlade.</p> <p>5. Rešenjem o imenovanju političkog savetnika, pretpostavljeni mu određuje oblast političkog savetovanja.</p> <p>6. Za političkog savetnika imenuje se lice koje ispunjava sledeće uslove:</p> <p>6.1. Da je državljanin Republike Kosovo;</p> <p>6.2. Da je punoletan i da ima punu sposobnost za rad;</p> <p>6.3. Da je kvalifikovan i profesionalno iskusan;</p> <p>6.4. Da nije osuđen pravosnažnom sudskom odlukom.</p> <p>7. Politički savetnik ne može:</p>
--	---	---

7.1. Ushtrojë çfarëdo pushteti ligjor, për ushtrimin e të cilit është kompetent eprori i tij;

7.2. Autorizojë shpenzimin e fondeve publike;

7.3. Ushtrojë kompetenca drejtuese ose kompetenca të tjera administrative në shërbimin civil.

Neni 14
Këshilltarët e jashtëm politik

1. Këshilltari i jashtëm politik është kategori e veçantë e zyrtarëve publikë, i cili e këshillon eprorin e tij mbi bazën e analizimit, vlerësimit të politikave me qëllim të arritjes së objektivave të përcaktuara me Programin e Qeverisë dhe me dokumentet e tjera të politikave dhe i përgjigjet eprorit të tij.

2. Këshilltari i jashtëm politik emërohet drejtpërdrejt nga Kryeministri, zëvendëskryeministri dhe ministri, (në tekstin e mëtejshëm: eprori) dhe u pushon mandati me përfundimin e mandatit të eprorit të tyre, nëse kjo marrëdhënie e punës nuk ndërpritet më herët.

3. Këshilltari i jashtëm politik nuk paguhet nga buxheti dhe nuk shkakton shpenzime

7.1. Exercise any legal power, for the exercise of which his/her line manager is competent;

7.2. Authorize the spending of public funds;

7.3. Exercise management or other administrative powers in the civil service.

Article 14
External political advisors

1. The external political advisor is a special category of public officials, who advises his/her line manager on the basis of policy analysis, evaluation in order to achieve the objectives set by the Government Program and other policy documents and reports to his/her line manager.

2. The external political advisor is appointed directly by the Prime Minister, the Deputy Prime Minister and the Minister, (hereinafter: the line manager) and their mandate is terminated upon the expiration of the term of their line manager, if this employment relationship is not terminated earlier.

3. The external political advisor is not paid from the budget and does not cause

7.1. Vršiti bilo koje zakonsko ovlašćenje za čije vršenje je nadležan njegov pretpostavljeni;

7.2. Ovlastiti trošenje javnih sredstava;

7.3. Vršiti rukovodeća ili druga upravna ovlašćenja u državnoj službi.

Član 14
Savetnici za spoljnu politiku

1. Savetnik za spoljnu politiku je posebna kategorija javnih funkcionera, koji savetuje svog pretpostavljenog na osnovu analize, evaluacije politike u cilju ostvarivanja ciljeva postavljenih Programom Vlade i drugim političkim dokumentima i izveštava pretpostavljenog.

2. Savetnika za spoljnu politiku postavljaju neposredno predsednik Vlade, potpredsednik Vlade i ministar (u daljem tekstu: pretpostavljeni) i prestaje mu mandat istekom mandata pretpostavljenog, ako ovaj radni odnos ne prestane ranije.

3. Savetnik za spoljnu politiku se ne plaća iz budžeta i ne izaziva troškove za budžet

për buxhetin e Republikës së Kosovës.

4. Përjashtimisht nga paragrafi 3 i këtij neni, nëse eprori e sheh të arsyeshme mund ta autorizojë pjesëmarrjen e Këshilltarit të jashtëm në ndonjë udhëtim zyrtar jashtë vendit dhe me këtë rast shpenzimet e udhëtimit do të mbulohen nga buxheti i institucionit, në qoftëse nuk mund të sigurohet financim tjetër.

5. Kushtet e parapara me nenin 13 paragrafin 4 dhe paragrafin 5 nënparagrafët 5.2, 5.3 dhe 5.4, si dhe paragrafin 6 zbatohen edhe për këshilltarët e jashtëm politik.

Neni 15 Nëpunësit në Kabinete

1. Me qëllim të ofrimit të ndihmës teknike dhe administrative, pranë kabineteve të Kryeministrit, zëvendëskryeministrave, ministrave dhe zëvendësministrave, emërohen nëpunësit në kabinete.

2. Të gjithë nëpunësve të punësuar në kabinete u pushon mandati me përfundimin e mandatit të eprorit të tyre, nëse kjo marrëdhënie e punës nuk ndërpritet më herët.

expenses for the budget of the Republic of Kosovo.

4. Exceptionally from paragraph 3 of this article, if the line manager deems it reasonable, he/she may authorize the participation of the External Advisor in an official trip abroad and in this case the travel expenses will be covered by the budget of the institution, if no other funding is provided.

5. The conditions provided by Article 13, paragraph 4 and paragraph 5, subparagraphs 5.2, 5.3 and 5.4, as well as paragraph 6 shall also apply to foreign political advisors.

Article 15 Officials in Cabinets

1. In order to provide technical and administrative assistance to the cabinets of the Prime Minister, Deputy Prime Ministers, Ministers and Deputy Ministers, officials shall be appointed to cabinets.

2. The mandate of all officials employed in cabinets is terminated at the end of the term of their line manager, if this employment relationship is not terminated earlier.

Republike Kosovo.

4. Izuzev stava 3. ovog člana, ako pretpostavljeni smatra da je to razumno, može ovlastiti učešće spoljnog savetnika na službenom putovanju u inostranstvo i u tom slučaju putni troškovi će biti pokriveni iz budžeta ustanove, ako on ne može se obezbediti druga finansijska sredstva.

5. Uslovi iz člana 13 stav 4 i stav 5 podstav 5.2, 5.3 i 5.4, kao i stav 6 primenjuju se i na strane političke savetnike.

Član 15 Službenici u kabinetima

1. U cilju pružanja tehničke i administrativne pomoći kabinetima premijera, potpredsednika Vlade, ministara i zamenika ministara imenuju se službenici kabineta.

2. Svim zaposlenima u kabinetima prestaje mandat po isteku mandata nadređenog, ako ovaj radni odnos ne prestane ranije.

KAPITULLI IV - MËNYRA E PUNËS SË QEVERISË

Neni 16 Mbledhjet e Qeverisë

1. Mbledhjet e Qeverisë thirren dhe kryesohen nga Kryeministri apo nga i autorizuari i tij.
2. Qeveria ka kuorum nëse në mbledhje janë të pranishëm shumica e anëtarëve të saj. Nëse Qeveria ka numër çift të anëtarëve, atëherë konsiderohet se ekziston kuorumi nëse janë të pranishëm gjysma e anëtarëve të Qeverisë, duke përfshirë Kryeministrin.
3. Kur zëvendësministri merr pjesë në mbledhje të Qeverisë, në pajtim me nenin 12 paragrafi 4, ka të drejtën e fjalës, krijon kuorumin dhe ka të drejtën e votës.
4. Përrjashtimisht nga paragrafi 3 i këtij neni, kur zëvendësministri merr pjesë në mbledhje të Qeverisë, në pajtim me nenin 12 paragrafi 5 nënparagrafi 5.1, ka të drejtën e fjalës, por nuk krijon kuorumin dhe nuk ka të drejtën e votës.
5. Votimi në mbledhje të Qeverisë është i hapur. Vendimet merren me shumicën e

CHAPTER IV – MANNER OF GOVERNMENT WORK

Article 16 Meetings of the Government

1. Government meetings are convened and chaired by the Prime Minister or his/her authorized representative.
2. The government has a quorum if a majority of its members are present at the meeting. If the Government has an even number of members, then a quorum is considered to exist, if half of the members of the Government are present, including the Prime Minister.
3. When the deputy minister participates in a meeting of the Government, in accordance with Article 12 paragraph 4, he/she has the right to speak, creates a quorum and has the right to vote.
4. Exceptionally from paragraph 3 of this Article, when the deputy minister participates in a meeting of the Government, in accordance with Article 12 paragraph 5 subparagraph 5.1, has the right to speak, but does not create a quorum and does not have the right to vote.
5. Voting in Government meetings is open. Decisions are taken by a majority vote of

GLAVA IV – NAČIN RADA VLADE

Član 16 Sastanci vlade

1. Sednice Vlade saziva i njima predsedava predsednik Vlade ili njegov ovlašćeni predstavnik.
2. Vlada ima kvorum ako je sednici prisutna većina njenih članova. Ako Vlada ima paran broj članova, smatra se da postoji kvorum ako je prisutna polovina članova Vlade, uključujući i predsednika Vlade.
3. Kada zamenik ministra učestvuje na sednici Vlade, u skladu sa članom 12 stav 4, ima pravo da govori, stvara kvorum i ima pravo glasa.
4. Izuzetno od stava 3. ovog člana, kada zamenik ministra učestvuje na sednici Vlade, u skladu sa članom 12 stav 5 podstav 5.1, ima pravo da govori, ali ne stvara kvorum i nema pravo glasa. .
5. Glasanje na sednicama Vlade je otvoreno. Odluke se donose većinom

<p>votave të anëtarëve prezent. Nëse Qeveria ka numër çift të anëtarëve, vendimi miratohet nëse së paku gjysma e anëtarëve prezent kanë votuar për të dhe nëse për të ka votuar edhe Kryeministri.</p> <p>6. Në situata apo raste të veçanta, me kërkesën e Kryeministrit apo të autorizuarit të tij, Qeveria mund të mbajë:</p> <p>6.1. Mbledhje të jashtëzakonshme, në të cilat shqyrtohen dhe vendosen çështjet e natyrës urgjente;</p> <p>6.2. Mbledhje elektronike, kur për arsye të caktuara nuk është e mundur të mbahet mbledhja me prezencën fizike të anëtarëve të Qeverisë. Në raste të tilla, përmes mjeteve të komunikimit elektronik, Qeveria shqyrton dhe vendos lidhur me çështjet e caktuara.</p> <p>7. Mbledhjet e Qeverisë duhet të regjistrohen në procesverbal dhe transkript, të cilat ruhen në Zyrën e Kryeministrit.</p> <p>8. Rregullat e tjera të hollësishme për organizimin dhe mbajtjen e mbledhjeve të Qeverisë, përfshirë mbledhjet e jashtëzakonshme dhe elektronike, përcaktohen me Rregulloren e Punës së Qeverisë.</p>	<p>the members present. If the Government has an even number of members, the decision is approved if at least half of the members present voted for it and if the Prime Minister also voted for it.</p> <p>6. In special situations or cases, at the request of the Prime Minister or his authorized representative, the Government may hold:</p> <p>6.1. Extraordinary meetings, where issues of an urgent nature are considered and decided;</p> <p>6.2. Electronic meeting, when for certain reasons it is not possible to hold the meeting with the physical presence of members of the Government. In such cases, through electronic means of communication, the Government reviews and decides on certain issues.</p> <p>7. Government meetings must be recorded in minutes and transcripts, which are kept in the Office of the Prime Minister.</p> <p>8. Other detailed rules for the organization and holding of Government meetings, including extraordinary and electronic meetings, are determined by the Rules of Procedure of the Government.</p>	<p>glasova prisutnih članova. Ako Vlada ima paran broj članova, odluka je usvojena ako je za nju glasala najmanje polovina prisutnih članova i ako je za nju glasao i predsednik Vlade.</p> <p>6. U posebnim situacijama ili slučajevima, na zahtev predsednika Vlade ili njegovog ovlašćenog predstavnika, Vlada može održati:</p> <p>6.1. Vanredne sastanke, na kojima se razmatraju i rešavaju pitanja hitne prirode;</p> <p>6.2. Elektronski sastanak, kada iz određenih razloga nije moguće održati sastanak uz fizičko prisustvo članova Vlade. U takvim slučajevima, putem elektronskih sredstava komunikacije, Vlada razmatra i odlučuje o određenim pitanjima.</p> <p>7. Sednice Vlade moraju se evidentirati u zapisnicima i transkriptima, koji se čuvaju u kabinetu premijera.</p> <p>8. Druga bliža pravila za organizovanje i održavanje sednica Vlade, uključujući vanredne i elektronske sednice, utvrđuju se Poslovníkom Vlade.</p>
---	---	--

<p style="text-align: center;">Neni 17 Transparenca e punës së Qeverisë</p> <p>1. Qeveria e informon publikun për punën e saj, duke siguruar sistem koherent dhe të koordinuar, për të komunikuar me publikun për politikën dhe aktivitetet e saj.</p> <p>2. Kryeministri apo zëdhënësi i Qeverisë i emëruar nga Kryeministri sigurojnë që mediat të informohen në mënyrë të rregullt për aktivitetet e Kryeministrit dhe zhvillimin e politikave në Qeveri.</p> <p>3. Zëvendëskryeministrat dhe ministrat e Qeverisë apo zëdhënësi i tyre sigurojnë që mediat të informohen në mënyrë të rregullt për aktivitetet e tyre.</p> <p>4. Dokumentet e Qeverisë janë publike, me përjashtim të dokumenteve që janë të klasifikuara në bazë të ligjit përkatës për klasifikimin e informacionit. Qeveria i nënshtrohet parimeve të transparencës për punën dhe vendimmarrjen e saj dhe siguron që:</p> <p style="padding-left: 40px;">4.1. Mbledhjet të mbahen në mënyrë të hapur, duke dhënë sinjal transmetimi për çdo media të interesuar për transmetimin e mbledhjeve të saj, me përjashtim të rasteve kur Qeveria vendos mbylljen e tyre për shkak të</p>	<p style="text-align: center;">Article 17 Transparency of Government's work</p> <p>1. The government informs the public about its work, providing a coherent and coordinated system, to communicate with the public about its policies and activities.</p> <p>2. The Prime Minister or the Government Spokesperson appointed by the Prime Minister shall ensure that the media are regularly informed about the activities of the Prime Minister and the development of policies in the Government.</p> <p>3. The Deputy Prime Ministers and Ministers of the Government or their spokesperson shall ensure that the media are regularly informed about their activities.</p> <p>4. Government documents are public, with the exception of documents that are classified according to the relevant Law on information classification. The government adheres to the principles of transparency in its work and decision-making and ensures that:</p> <p style="padding-left: 40px;">4.1. Meetings should be held in an open manner, giving a broadcast signal to any media interested in broadcasting its meetings, except when the Government decides to close them due to the exposure of information which is</p>	<p style="text-align: center;">Član 17 Transparentnost rada vlade</p> <p>1. Vlada obaveštava javnost o svom radu, obezbeđujući koherentan i koordinisan sistem, za komunikaciju sa javnošću o svojim politikama i aktivnostima.</p> <p>2. Premijer ili portparol vlade koga imenuje premijer obezbeđuje da mediji budu redovno informisani o aktivnostima premijera i razvoju politika u vladi.</p> <p>3. Zamenici premijera i ministri vlade ili njihov portparol dužni su da obezbede redovno informisanje medija o njihovim aktivnostima.</p> <p>4. Vladini dokumenti su javni, osim dokumenata koji su klasifikovani prema relevantnom zakonu o klasifikaciji informacije. Vlada se u svom radu i odlučivanju pridržava principa transparentnosti i obezbeđuje se:</p> <p style="padding-left: 40px;">4.1. Sednice održavaju na otvoren način, uz davanje signala svim medijima zainteresovanim da prenose sednice, osim kada vlada odluči da ih zatvori zbog izlaganja informacija koje su klasifikovane prema relevantnom</p>

<p>ekspozimit të informatave të cilat janë të klasifikuara në bazë të ligjit përkatës për klasifikimin e informacioneve;</p> <p>4.2. Rendi i Ditës së mbledhjes së Qeverisë bëhet publik së paku njëzetekatër (24) orë përpara mbajtjes së mbledhjes saj;</p> <p>4.3. Vendimet e Qeverisë publikohen në Gazetën Zyrtare jo më vonë se njëzet e katër (24) orë pasi që të jenë nënshkruar nga Kryeministri dhe mbesin publike pa asnjë kufizim kohor.</p> <p>5. Vendimet për emërimin apo shkarkimin e anëtarëve të Qeverisë, zëvendësministrave, këshilltarëve politikë dhe këshilltarëve të jashtëm publikohen në faqen elektronike të Zyrës së Kryeministrit.</p> <p>6. Rregullat dhe parimet e shërbimit të komunikimit qeveritar me publikun përcaktohen me rregullore të propozuar nga Zyra e Kryeministrit dhe të miratuar nga Qeveria.</p> <p style="text-align: center;">Neni 18 Trupat qeveritare</p> <p>1. Qeveria mund të themelojë trupa qeveritare për të ndihmuar dhe lehtësuar punën e saj.</p>	<p>classified according to the relevant Law on information classification;</p> <p>4.2. The agenda of the Government meeting is made public at least twenty-four (24) hours before the meeting;</p> <p>4.3. Government decisions are published in the Official Gazette no later than twenty-four (24) hours after they have been signed by the Prime Minister and remain public without any time limit.</p> <p>5. Decisions on the appointment or dismissal of members of the Government, Deputy Ministers, Political Advisers and Foreign Advisers are published on the website of the Office of the Prime Minister.</p> <p>6. The rules and principles of the government communication service with the public are determined by regulations proposed by the Office of the Prime Minister and approved by the Government.</p> <p style="text-align: center;">Article 18 Government bodies</p> <p>1. The government may establish Government Bodies to assist and facilitate its work.</p>	<p>zakonu o klasifikaciji informacija;</p> <p>4.2. Dnevni red sednice vlade objavljuje najmanje dvadeset četiri (24) sata pre sednice;</p> <p>4.3. Odluke vlade objavljuju u Službenom listu najkasnije dvadeset četiri (24) sata nakon što ih je potpisao premijer i ostaju javne bez ikakvog vremenskog ograničenja.</p> <p>5. Odluke o imenovanju ili razrešenju članova vlade, zamenika ministara, političkih savetnika i spoljnih savetnika objavljuju se na internet stranici Kancelarije premijera.</p> <p>6. Pravila i načela službe za komunikaciju vlade sa javnošću utvrđuju se propisima koje predlaže Kancelarija, a usvaja ih vlada.</p> <p style="text-align: center;">Član 18 Vladina tela</p> <p>1. Vlada može osnovati vladina tela koja pomažu i olakšavaju njen rad.</p>
--	--	--

<p>2. Themelimi i trupave qeveritare, përveç në rastet kur kërkohet ose autorizohet me ligj, arsyetohet me plotësimin e kriterëve të domosdoshmërisë, duke përfshirë në veçanti programin e Qeverisë dhe kompleksitetin e tij, efikasitetin ekonomik, efektivitetin, vlerën për para, parandalimin e tepricës dhe proporcionalitetin.</p> <p>3. Trupat qeveritar shqyrtojnë çështje të caktuara dhe përgatisin propozime, të cilat kanë të bëjnë me fushën e përgjegjësisë administrative të dy apo më shumë ministrive.</p> <p>4. Qeveria me vendimin për themelimin e trupës qeveritare përcakton përbërjen, mandatin e trupës qeveritare, si dhe njësinë përkatëse në Zyrën e Kryeministrit apo në ministrinë e caktuar, e cila shërben si sekretariat administrativ për punën e trupës.</p> <p>5. Trupat qeveritare, varësisht nga lloji i tyre, përbëhen nga anëtarët e qeverisë, zëvendësministrat, të emëruarit e tyre dhe zyrtarët publikë.</p> <p>6. Gjatë punës së trupave qeveritare mund të ftohen ekspertë të jashtëm të fushave specifike, përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile dhe subjekteve të tjera.</p>	<p>2. The establishment of Government Bodies, unless required or authorized by law, shall be justified by meeting the criteria of necessity, including in particular the Government program and its complexity, economic efficiency, effectiveness, value for money, prevention of surplus and proportionality.</p> <p>3. Government Bodies shall review certain issues and prepare proposals, which relate to the area of administrative responsibility of two or more ministries.</p> <p>4. The Government, by the decision for the establishment of the Government Body, shall determine the composition, the mandate of the Government Body, and the respective unit in the Office of the Prime Minister or in the designated ministry, which serves as the administrative secretariat for the work of the body.</p> <p>5. Government Bodies, depending on their type, shall consist of members of the government, deputy ministers, their appointees and public officials.</p> <p>6. During the work of Government Bodies, external experts in specific fields, representatives of civil society organizations, and other entities may be invited.</p>	<p>2. Osnivanje vladinih tela, osim u slučajevima kada se zahteva ili ovlašćuje, opravdava se ispunjavanjem kriterijuma neophodnosti, uključujući posebno program vlade i njegovu složenost, ekonomsku efikasnost, efektivnost, vrednost za novac, sprečavanje viška i proporcionalnost.</p> <p>3. Vladina tela razmatraju pojedina pitanja i pripremaju predloge, koji se odnose na oblast administrativne odgovornosti dva ili više ministarstava.</p> <p>4. Vlada odlukom o osnivanju vladinih tela utvrđuje sastav, mandat vladinih tela i dotičnu jedinicu u Kancelariji premijera ili u nadležnom ministarstvu, koje služi kao administrativni sekretarijat za rad tela.</p> <p>5. Vladina tela, u zavisnosti od vrste, čine članovi vlade, zamenici ministara, njihova imenovana lica i javni službenici.</p> <p>6. Za vreme rada vladinih tela mogu se pozvati spoljni stručnjaci iz određenih oblasti, predstavnici organizacija civilnog društva i drugih subjekata.</p>
---	---	--

7. Rregullat e hollësishme për llojin e trupës qeveritare, mënyrën e punës dhe fushëveprimin e tyre caktohen me Rregulloren e Punës së Qeverisë.

KAPITULLI V - MBËSHTETJA DHE KORDINIMI I PUNËS SË QEVERISË

Neni 19 Zyra e Kryeministrit

1. Kryeministri udhëheq Zyrën e Kryeministrit.

2. Zyra e Kryeministrit koordinon punën e Qeverisë në relacion me Kuvendin, Presidentin dhe institucionet e pavarura.

3. Zyra e Kryeministrit mbështet veprimtarinë e Qeverisë në tërësi, Kryeministrit, zëvendëskryeministrave dhe ministrave dhe është përgjegjëse për:

3.1. Propozimin e amendamenteve kushtetuese, nismave për marrëveshje ndërkombëtare, projektligjeve, projekt akteve nënligjore, koncept dokumenteve, vlerësimeve ex post të legjislacionit, projekt dokumenteve strategjike dhe propozimeve të tjera nga

7. Detailed rules for the type of the Government Body, the manner of work, and their scope, shall be determined by the Rules of Procedure of the Government.

CHAPTER V - SUPPORT AND COORDINATION OF GOVERNMENT WORK

Article 19 Office of the Prime Minister

1. The Prime Minister shall head the Office of the Prime Minister.

2. The Office of the Prime Minister shall coordinate the work of the Government in relation to the Assembly, the President and independent institutions.

3. The Office of the Prime Minister shall support the activity of the Government as a whole, of the Prime Minister, of the Deputy Prime Ministers and Ministers, and shall be responsible for:

3.1. Proposing constitutional amendments, initiatives for international agreements, draft laws, draft sub-legal acts, concept documents, ex post evaluations of legislation, draft strategic documents and other proposals from the scope of action of the Government as a

7. Detaljnjia pravila o vrsti vladinih tela, načinu rada i njihovom delokrugu utvrđuju se Poslovníkom o radu vlade.

POGLAVLJE V – PODRŠKA I KOORDINACIJA RADA VLADE

Član 19 Kancelarija premijera

1. Premijer rukovodi Kancelarijom premijera.

2. Kancelarija premijera koordinira rad vlade u odnosu na Skupštinu, predsjednika i nezavisne institucije.

3. Kabinet premijera podržava rad vlade u celini, premijera, zamenika premijera Vlade i ministre i odgovoran je za:

3.1. Predlaganje ustavnih amandmana, inicijativa za međunarodne ugovore, predloge zakona, predloge podzakonskih akata, koncept dokumenata, ex post procene zakona, predloge strateških dokumenata i drugih predloga iz delokruga vlade u celini i

<p>fushëveprimi i Qeverisë si tërësi dhe Zyrës së Kryeministrit, si dhe mbikëqyr dhe siguron zbatimin e tyre;</p> <p>3.2. Përgatitjen dhe organizimin e mbledhjeve të Qeverisë dhe mbledhjeve tjera të kryesuara nga Kryeministri ose nga një zëvendëskryeministër në emër të tij;</p> <p>3.3. Koordinimin e përgatitjes së planit vjetor të punës së Qeverisë dhe mbikëqyrjen e zbatimit të tij;</p> <p>3.4. Drejtimin dhe koordinimin e marrëdhënieve të Qeverisë me publikun;</p> <p>3.5. Drejtimin dhe koordinimin e procesit të monitorimit të performancës së Qeverisë;</p> <p>3.6. Ushtimin e funksioneve horizontale si prioritete strategjike të cilat janë caktuar me ligj, vendim të Qeverisë ose të Kryeministrit;</p> <p>3.7. Koordinimin e ministrive në lidhje me planifikimin, hartimin, shqyrtimin e konsistencës me Kushtetutën dhe legjislacionin në fuqi, si dhe sigurimin e cilësisë së hartimit për propozimin e amendamenteve kushtetuese, nismave për marrëveshje ndërkombëtare, projektligjeve, projekt akteve nënligjore, përgatitjen e mendimit të Qeverisë për nismat ligjore, propozues e të cilave nuk</p>	<p>whole and the Office of the Prime Minister and monitors and ensures their implementation;</p> <p>3.2. Preparing and organizing the Government meetings and other meetings chaired by the Prime Minister or a Deputy Prime Minister on his behalf;</p> <p>3.3. Coordinating the preparation of the Government's annual work plan and overseeing its implementation;</p> <p>3.4. Directing and coordinating Government relations with the public;</p> <p>3.5. Directing and coordinating the Government performance monitoring process;</p> <p>3.6. Exercising horizontal functions as strategic priorities which are determined by law, decision of the Government or the Prime Minister;</p> <p>3.7. Coordinating the ministries regarding planning, drafting, review of consistency with the Constitution and legislation in force, as well as ensuring the quality of drafting for proposals for constitutional amendments, initiatives for international agreements, draft laws, draft sub-legal acts, preparation of the Government's opinion on legal initiatives, proposed by the</p>	<p>Kancelarije premijera, kao i nadgleda i obezbeđuje njihovo sprovođenje;</p> <p>3.2. Pripremanje i organizovanje sednica vlade i drugih sednica kojima predsedava premijer ili jedan od zamenika premijera u njegovo ime;</p> <p>3.3. Koordinaciju izrade godišnjeg plana rada vlade i nadgleda njegovo sprovođenje;</p> <p>3.4. Usmeravanje i koordinaciju odnosa vlade sa javnošću;</p> <p>3.5. Usmeravanje i koordinaciju procesa praćenja učinka vlade;</p> <p>3.6. Obavljanje horizontalnih funkcija kao strateških prioriteta utvrđenih zakonom, odlukom vlade ili premijera;</p> <p>3.7. Koordinaciju ministarstava u pogledu planiranja, izrade, kontrole usklađenosti sa Ustavom i zakonima na snazi, kao i obezbeđivanje kvaliteta izrade predloga ustavnih amandmana, inicijativa za međunarodne ugovore, predloga zakona, predloga podzakonskih akata, pripremu mišljenja vlade o zakonskim inicijativama, čiji predlagač nije vlada, koncept</p>
--	--	---

<p>është Qeveria, koncept dokumenteve, vlerësimeve ex-post të legjislacionit, projekt dokumenteve strategjike dhe propozimeve të tjera nga fushëveprimi i ministrive si dhe mbikëqyr zbatimin e tyre.</p> <p>4. Gjatë ushtrimit të përgjegjësisë së saj, Zyra e Kryeministrit, lëshon opinione, ofron udhëzime, kryen kontrollin e cilësisë së propozimeve të ndryshme nga organet propozuese, si dhe ofron këshilla profesionale për Kryeministrin dhe Qeverinë.</p> <p>5. Duke marrë parasysh specifikat e përcaktuara me këtë ligj, Zyra e Kryeministrit ka strukturën e veçantë organizative e cila përcaktohet me Rregulloren për Strukturën organizative të Zyrës së Kryeministrit.</p> <p>6. Zyra e Kryeministrit ushtron edhe përgjegjësitë e tjera të cilat i janë caktuar me legjislacionin në fuqi, me kërkesën e Kryeministrit apo të Qeverisë.</p> <p>7. Mënyra e ofrimit dhe koordinimit të shërbimit ligjor qeveritar, procesit të planifikimit strategjik, hartimit të koncept dokumenteve, vlerësimeve ex-post të legjislacionit, si dhe përcaktimi i standardeve minimale të konsultimit me publikun, përcaktohen me akte nënligjore të</p>	<p>Government, concept documents, ex-post assessments of legislation, draft strategic documents and other proposals from the scope of ministries and oversees their implementation.</p> <p>4. In the exercise of its responsibilities, the Office of the Prime Minister shall issue opinions, provide guidelines, conduct quality control of various proposals by the proposing bodies, and provide professional advice to the Prime Minister and the Government.</p> <p>5. Taking into account the specifics defined by this law, the Office of the Prime Minister shall have a special organizational structure which is defined by the Regulation on Organizational Structure of the Office of the Prime Minister.</p> <p>6. The Office of the Prime Minister shall also exercise other responsibilities assigned to it by the legislation in force, at the request of the Prime Minister or the Government.</p> <p>7. The manner of providing and coordinating government legal service, strategic planning process, drafting concept documents, ex-post assessments of legislation, and setting minimum standards for public consultation, shall be determined by sub-legal acts proposed by the Office of</p>	<p>dokumenata, ex-post procene zakonodavstva, predloga strateških dokumenata i drugih predloga iz delokruga ministarstava i nadgleda njihovo sprovođenje.</p> <p>4. Kancelarija premijera u vršenju svojih nadležnosti izdaje mišljenja, pruža uputstva, vrši kontrolu kvaliteta različitih predloga organa predlagača i pruža stručne savete premijeru i vladi.</p> <p>5. Imajući u vidu specifičnosti definisane ovim zakonom, Kancelarija premijera ima posebnu organizacionu strukturu koja je definisana Uredbom o organizacionoj strukturi Kancelarije premijera.</p> <p>6. Kancelarija premijera vrši i druge dužnosti koje su joj dodeljene zakonom na snazi, na zahtev premijera ili vlade.</p> <p>7. Način pružanja i koordinacije vladine pravne službe, proces strateškog planiranja, izrada koncept dokumenata, ex-post procena zakonodavstva, kao i utvrđivanje minimalnih standarda za javne konsultacije, utvrđuju se podzakonskim aktima koje predlaže Kancelarija premijera i odobrava</p>
---	---	--

propozuara nga Zyra e Kryeministrit dhe të miratuara nga Qeveria.

Neni 20
Sekretari i përgjithshëm i Zyrës së
Kryeministrit

1. Sekretari i Përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit është nëpunësi më i lartë civil në Qeverinë e Republikës së Kosovës dhe është zyrtar kryesor administrativ i Zyrës së Kryeministrit.

2. Sekretari i Përgjithshëm i Zyrës e Kryeministrit i raporton dhe i përgjigjet drejtpërdrejt Kryeministrit dhe ushtron detyrën nën drejtimin dhe udhëzimet e Kryeministrit.

3. Sekretari i Përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit udhëheqë zyrat dhe njësitë përkatëse të Zyrës së Kryeministrit në pajtim me legjislacionin përkatës në fuqi.

4. Sekretari i Përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit koordinon punën me sekretarët e përgjithshëm të ministrive.

5. Sekretari i Përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit ka këto përgjegjësi kryesore:

5.1. Mbështet Kryeministrin dhe

the Prime Minister and approved by the Government.

Article 20
Secretary General of the Office of the
Prime Minister

1. The Secretary General of the Office of the Prime Minister shall be the highest civil servant in the Government of the Republic of Kosovo and is the chief administrative officer of the Office of the Prime Minister.

2. The Secretary General of the Office of the Prime Minister shall report and respond directly to the Prime Minister and shall exercise his duties under the direction and guidance of the Prime Minister.

3. The Secretary General of the Office of the Prime Minister shall head the relevant offices and units of the Office of the Prime Minister in accordance with the relevant legislation in force.

4. The Secretary General of the Office of the Prime Minister shall coordinate the work with the Secretary General of the ministries.

5. The Secretary General of the Office of the Prime Minister shall have the following main responsibilities:

5.1. Supports the Prime Minister and

vlada.

Član 20
Generalni sekretar Kancelarije
premijera

1. Generalni sekretar Kancelarije premijera je najviši civilni službenik u vladi Republike Kosovo i glavni je administrativni službenik Kancelarije premijera.

2. Generalni sekretar Kancelarije premijera izveštava i podnosi izveštaj direktno premijeru i obavlja svoju dužnost pod upravom i uputstvima premijera.

3. Generalni sekretar Kancelarije premijera rukovodi odgovarajućim kancelarijama i jedinicama u skladu sa relevantnim zakonodavstvom na snazi.

4. Generalni sekretar Kancelarije premijera koordinira rad sa generalnim sekretarima ministarstava.

5. Generalni sekretar Kancelarije premijera ima sledeće glavne odgovornosti:

5.1. Podržava premijera i zamenike

